



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.2374 të datës 25.06.2024, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më date 25.06.2024 shpall:

KONKURS I JASHTËM

Pozita e Punës: Punëtor Sigurimi

Numri i pozitave: 1

Niveli i Pagës: XXI

Kohëzgjatja e kontratës: Ne afat të pacaktuar

Kualifikimet: Shkollim i mesëm

Përvoja e punës: 1 vit përvojë pune

Periudha provuese: 3 muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Siguron objektet dhe pasurisë së ndërmarrjes në përgjithësi në aspektin e sigurisë fizike.
- Gjatë pranimit-dorëzimit të detyrës në libër të veçantë mban evidencë mbi vërejtjet që ka gjatë orarit të tij të punës;
- Nuk e lejon hyrjen dhe prezencën e njerëzve të pa autorizuar gjatë ditës dhe natës në objektet e ndërmarrjes;
- Udhëheqë librin e evidentimit mbi hyrje dhe dalje të automjeteve, punëtorëve dhe personave të tjerë duke evidentuar kohën e hyrjes dhe dalje nga hapësira e ndërmarrjes;
- Në rast të ndonjë parregullsie gjatë procesit të punës mund të kërkon ndihmë nga policia nëse është i penguar në kryerjen e detyrës;
- Është përgjegjës për krejt atë çka humb në ndërmarrje gjatë ndërrimit të tij;
- Pas përfundimit të orarit të rregullt të punës në sektorët e caktuar, bën inspektimin për të verifikuar se a është gjithçka në rregull;
- Duhet të sigurojë, kontrollojë të gjitha pajisjet apo depot se a janë të mbyllura dyert e tyre kur e pranon detyrë;
- Pas çdo ndërrimi duhet të raportoj tek përgjegjësi i sigurimit, për atë që ka ndodhur gjatë ndërrimit;
- Gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të caktuara është i obliguar që të sillet në pajtim me dispozitat e rregulloreve të ndërmarrjes dhe Kodit të Mirësjelljes dhe Etikës;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të ngarkuara nga Mbikëqyrimi;
- Për punën e tij i përgjigjet Përgjegjësit të Sigurimit.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë e shkollës së mesme, licencë për Sigurim Fizik;



- Përvojë pune 1 vit;
- Aftësi të mira komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë në grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune> ;
- CV
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtër i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com

Konkursi është i hapur nga data **25.06.2024** dhe përfundon më datë **09.07.2024** në ora **24.00**.

Kalendari i përparësive të zhvillimit të procedurave: Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **15.08.2024**.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:
25.06.2024